



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 1572 prot.

Himarë, më 30.03.2022

VENDIM NR 14 DATË 30.03.2022

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK MARS 2022

Mbështetur në nenet 34,40,41,45,55 të ligjit nr 139/2015 “Për Vetëeverisjen Vendore”, ligjin 9936 datë 26.08.2008 “Për Menaxhimin e Sistemimin Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 të ligjit Nr 68/2017 “Për Financat e Qeverisjes Vendore” ligjin Nr 10296 datë 08.07.2010. “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave “Mbi procedurat standarte të miratimit të buxhetit”, të ndryshuar, mbi njoftimin për transfertën e pakushtëzuar e përgjithëshme dhe sektoriale, për vitin 2022

Kshilli i Bashkisë pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Himarë; Miratoi me 13 PRO, 0 Kundër. 0 Abstenim

VENDOSI

1. Të miratohet ndryshimi mbi të ardhurat dhe shpenzimet sipas tabelës bashkëngjitur këtij Projekt-Vendimi
2. Shpenzimet “*Mallra dhe Sherbime të tjera 2022*” (Ilogaria ekonomike 602), të përdoren sipas tabelës mallra dhe shërbime bashkëngjitur këtij vendimi
3. Shpenzimet “*Investime për vitin 2022*” (Ilogaria ekonomike 231), të përdoret sipas tabelës investime, bashkëlidhur këtij Projekt-Vendimi.
4. Kryetari I Bashkisë autorizohet të bëjë transferimin e fondeve operative për artikuj të miratuar nga Këshilli Bashkiak Brenda institucionit.
5. Drejtorja e financës, planifikimit të buxhetit dhe integritit evropian, sektori I Financës, autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Keshilli Bashkiak sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
6. Ndryshimet të pasqyrohen në PBA 2023-2025 dhe VKB përkatëse.

KRYETARI
Dhimitër KAPAJ

